



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË  
BORDI

VENDIM

Nr. 322, Datë 12.12.2022

MBI

**MOSFILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “SUNPOWER 2017” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA CENTRALI FOTOVOLTAIK ME KAPACITET TË INSTALUAR 2 MW, NË POVELÇË, BASHKIA FIER**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2 gërma “a” të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 4, pika 1, gërma “a”, nenit 5, pika 1 gërma “a”, nenit 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19 pika 1 gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE, , në mbledhjen e tij të datës 12.12.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 2039/2 prot., datë 06.12.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, në Povelcë, Bashkia Fier”,

**Konstatoi se:**

- Shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 2013 prot., datë 30.11.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW, me vendndodhje në Povelcë, Bashkia Fier, Qarku Fier.
- Në zbatim të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, aplikuesi për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike duhet të depozitojë në ERE: dokumentacionin e përgjithshëm për të

gjitha aplikimet për pajisje me licencë (neni 9, pika 1); dokumentacionin specifik për licencën e prodhimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 2.1); Shtojcën 1, Shtojcën 1A dhe Shtojcën 2 të plotësuar; si dhe të ketë kryer pagesën për regjistrim dhe shqyrtim të një aplikimi (Aneksi A).

- Shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, në zbatim të Aneksit A të Rregullores.
- Nga aplikimi rezulton se shoqëria “SUNPOWER 2017” sh.p.k. ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të rregullores për nenin 9, pikën 1.1, gërmat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 2.1, gërmat “d”, “e” dhe “f”.
- Nga ky aplikim rezulton gjithashtu se mungon dokumentacioni si vijon:

## Neni 9

### Formati dhe dokumentacioni për aplikim

#### *Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ*

- **gërma “b”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin e gjendjes gjyqësore (Dëshmi Penaliteti) për administratorin e saj, me datë të rifreskuar sipas parashikimit të nenit 8, pika 3 të rregullores së licencimit dhe gjithashtu të depozitojë Vërtetimin e Gjendjes Gjyqësore për shoqërinë “SUNPOWER 2017” sh.p.k.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE strukturën organizative të saj të nënshkruar dhe/ose vulosur.

#### *Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal*

- **gërma “a”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj institucionit të sigurimeve shoqërore.
- **gërma “c”:** Shoqëria duhet të depozitojë në ERE pasqyrat financiare për vitet 2019 dhe 2020, të cilat nuk rezultojnë të publikuara as në ekstraktin e QKB-së. Gjithashtu, në kuadër të mbështetjes financiare për financimin e projektit, shoqëria duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës referuar vlerës së investimit të përcaktuar në kontratën me MIE-n dhe parashikimeve të planit të biznesit për mënyrën e financimit.

- **gërma “c”**: Plani i biznesit është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE original ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

### **Pika 2, Dokumentacioni specifik sipas tipit të licencës**

2.1 Për t’u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **gërma “a”**: Shoqëria duhet të bëjë me dije datën e fillimit të operimit të centralit. Po ashtu, duke qenë se shoqëria ka deklaruar se viti i ndërtimit të centralit është viti 2022, duhet të bëjë me dije nëse ka filluar punimet për ndërtimin e centralit, apo fazën në të cilën ndodhen ato. Gjithashtu shoqëriaduhet të paraqesë në ERE dokumentacionin teknik mbi të cilin bazon deklaratën e saj për jetëgjatësinë prej 30 vitesh të centralit fotovoltaik, pasi nga rastet analoge të mëhershme, ka rezultuar se teknikisht një panel nuk mund të ketë një jetëgjatësi më të madhe se 25 vite.
  - **gërma “b”**: Kontrata nr. 2772 Rep., nr. 875 Kol., datë 23.09.2022, është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE original ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
  - **gërma “c”**: Shkresa e OSSH sha nr. 2813/3 prot., datë 11.04.2022 “Miratim për pikë lidhje Central Fotovoltaik” nga rezulton se centrali fotovoltaik prodhues i subjektit “SUNPOWER 2017” sh.p.k. është depozituar në formatin fotokopje, ndaj në zbatim të nenit 8, pika 3 të rregullores shoqëria duhet ta depozitojë këtë dokument në ERE original ose fotokopje të njësuar me origjinalin.
- Në mbështetje të përcaktimeve të nenit 10, pikës 7 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike” e ndryshuar, nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

**Vendosi:**

1. Të mosfillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “SUNPOWER 2017” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 2 MW me vendndodhje në Povelçë, Bashkia Fier, Qarku Fier, për një afat 25-vjeçar.
2. Nëse aplikuesi, brenda 1 (një) muaji nga marrja dijani e vendimit për mosfillimin e procedurës, paraqet dokumentacionin thelbësor të konstatuar të munguar, dokumentacioni i paraqitur për aplikimin e mëparshëm dhe pagesa për aplikim do të konsiderohen të vlefshme për fillimin e procedurës.
3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë aplikuesin për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETAR**

**Petrit AHMETI**